REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr 4108 rep.
Nr 845/1 kol.

Taksa e pulles u likujdua

**KONTRATE SHITJE KUOTASH**

**Ne Tirane,** sot, me daten 06 Shtator 2012 (dy mije e dymbedhjete), u paraqiten personalisht para meje, NOTERE Anila Gjermeni, me adrese ne Bulevardin "Gjergj Fishta", ne katin e pare te pallatit qe ndodhet para hyrjes se godines se Gjykates Civile te Rrethit Gjyqesor Tirane, palet kontraktuese si vijon:

PALA SHITESE

1-SHOQERIA "**NISHOVA**" SH.P.K, me adrese ne Berat, Bogove, Nishovaj, Godine private prane Zyrave te Komunes, identifikuar me NIPT K89826401P, shoqeri me status aktiv (sipas ekstraktit te QKR) me perfaqesues te saj ligjor dhe njekohesisht Ortak I Vetem I saj , z. **FATMIR KOXHAJ**, biri I Hakiut, lindur me date 07.01.1950, ne Nishove, Berat, banues ne Durres, Lagja 14( sipas deklarimit te tij) madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga ana ime sipas leternjoftimit nr F00107036U( te paraqitur prej tij, po sot) .

SHOQERIA "**ARMANDI**" SH.P.K, me adrese ne Durres, Manez, Rade, godine private prane Shkolles, identifikuar me NIPT K01614502I, shoqeri me status aktiv ( sipas ekstarktit te QKR) me perfaqesues te saj ligjor, dhe njekohesisht Ortak I Vetem I saj z. **HYSNI BASHA**, biri I Muratit, llindur me date 24.02.1959, ne Cidhen , Diber, banues ne Manez, Durres (sipas deklarimit te tij te sotem ) madhor, mke zotesi te plote juridike dhe per te vepruar , identifikuar nga ana ime sipas leternjoftimit nr F90224141V (te paraqitur prej tij, po sot) .

PALA BLERESE:

SHOQERIA "**GEO ENERGY**" SRL, Shoqeri italiane , e regjistruar ne Regjistrin e Firmave ne Padova me nr 02880470246, me Seli ne Saletto (PD), Via Roma , S. N. C. Cap 35046, identifikuar me Kod Fiskal dhe numer regjistrimi 02880470246, e perfaqesuar sipas vendimit te Asamblesese shoqerise Geo Energy srl, date 16.07.2012 nga z. **ISIDORO REBATTO**, shtetas italian, lindur me date 28.10.1961, ne Este (PD), Itali, banues ne Este (PD, Via Sostegno N.3 I.2, identifikuar nepermjet karte identiteti italiane Nr. AS5642373, e vlefshme deri me date 22.07.2021.
ne prani te perkthyesit te gjuhes italiane Z. Arjan Selfo

SHOQERIA "**FIDALCO**" SPA, Shoqeri italiane, e regjistruar ne Regjistrin e Firmave ne Vicenza me nr 02026950242, me Seli ne Via Lago Di Garda, 28 Cap.36015 Schio (VI), identifikuar me Kod Fiskal dhe numer regjistrimi 02026950242, e perfaqesuar nga z. **GAETANO DAL COROBBO**, shtetas italian, lindur me date 19.07.1951, ne Caltrano (VI), Itali, banues ne Carre (VI), Via Balestri 5, identifikuar nepermjet karte identiteti italiane Nr. AN6901364, e vlefshme deri me date 19.02.2017
ne prani te perkthyesit te gjuhes italiane Z. Arjan Selfo

ARJAN SELFO
Perkthyes
TIRANE

BAZA LIGJORE

1- Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",
2- Kodi Civil i Republikes se Shqiperise;

1. Palet kerkuan redaktimin e kontrates se shitjes se kuotave te Shoqerise Nishova Energy shpk e cila zoteron Kontrate Koncensioni e Formes BOT ( Ndertim-Operim-Transferim per ndertimin e hidrocentraleve Nishova 1 dhe Nishova 2) Nr. 2850, Rep, Nr 379 kol date 09.09.2009, hartuar nga Notere Fatime Meta, Tirane midis Autoritetit Kontrakties –Ministrisa e Ekonomise , Tregetise dhe Energjitikes dhe Koncensionari -Bashkimi I Perkoheshem i Shoqerive Nishova shpk dhe Armandi sh.p.k.

qe vijon:

KUSHTE PARAPRAKE:

2. Shoqeria "NISHOVA ENERGY shpk , identifikuar me NIPT K99631401M, me ortake "NISHOVA" sh.p.k me 57% te kuotave dhe "ARMANDI" sh.p.k me 43% te kuotave , eshte e rregjistruar rregullisht si person juridik me pergjegjesi te kufizuar dhe deklaron se mbi te nuk rendon me asnje barresim, marreveshje kufizuese apo detyrim ndaj paleve te treta dhe gjendet e lire te realizoje lidhjen e kesaj Kontrate.
3. Me vendimin e dates 07.07.2012 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "NISHOVA" sh.p.k, eshte miratuar shitja e 57(pesedhjete e shtate) Pjese te Kapitalit te zoteruar prej shoqerise "NISHOVA" sh.p.k ne shoqerine "NISHOVA ENERGY" sh.p.k, tek bleresit, shoqerite "GEO ENERGY" SRL dhe "FIDALCO" SPA
4. Me vendimin date 07.07.2012 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "ARMANDI" sh.p.k, eshte miratuar shitja e 43(dyzet e tre) Pjese te Kapitalit te zoteruar prej shoqerise "ARMANDI" sh.p.k ne shoqerine "NISHOVA ENERGY" sh.p.k, tek bleresit, shoqerite "GEO ENERGY" SRL dhe "FIDALCO" SPA.
5. Me vendimin e dates 16.07.2012 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "GEO ENERGY" SRL, eshte miratuar blerja e 50(pesedhjete) Pjese te Kapitalit (ose perndryshe 50% te pjeseve te kapitalit) te "NISHOVA ENERGY" sh.p.k,
6. Me vendimin e dates 16.07.2012 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise "FIDALCO" SPA eshte miratuar blerja e 50(pesedhjete) Pjese te Kapitalit (ose perndryshe 50% te pjeseve te kapitalit) te "NISHOVA ENERGY" sh.p.k,
7. Kontrate koncensioni e Formes BOT ( Ndertim-Operim-Transferim per ndertimin e hidrocentraleve Nishova 1 dhe Nishova 2 , Nr. 2850, Rep, Nr 379 kol date 09.09.2009, hartuar nga Notere Fatime Meta, Tirane midis Ministrise se Ekonomise , Tregetise dhe Energjitikes dhe Bashkimi I Perkoheshem i shoqerive Nishova shpk dhe Armandi sh.p.k.
8. Me shkresen Nr 6316/1, date 31.07.2012 te Ministrise se Ekonomise , Tregetise dhe Energjitikes eshte miratuar transferimi I kuotave ne masen 100%te Shoqerise Koncensinare Nishova Energy sh.p.k. ne favor te shoqerise "GEO ENERGY" SRL ne masen 50% dhe shoqerise "FIDALCO" SPA. ne masen 50%

ARIAN SELF
Perkthyes
TIRANE

Me kushtin qe te ruhet emri I koncensionarit si dhe te mbarten te gjitha te drejtat dhe detyrimet e percaktuara ne kontraten Koncensionare te forms BOT date 09.09.2009 per ndertimin e hidrocentraleve Nishova 1 dhe Nishova 2 ndermjet Ministrise se Ekonomise dhe Bashkimit te shoqerive Nishova shpk dhe Armandi sh.p.k.

Me marreveshje te perbashket, te gjithe palet kane percaktuar se cmimi total per shitjen e 100 (njeqind) Pjese te Kapitalit, eshte 250.000 EURO (dyqind e pesedhjetemije euro) Shume e cila eshte likuiduar totalisht nga bleresit jashte zyres se noterise, me transferte bankare.

Shitesit, shoqerite "Nishova" sh.p.k dhe "Armandi" shpk, nepermjet perfaqesuesve te tyre, z. Fatmir KOXHAJ dhe z. Hysni BASHA, ne cilesine e zoteruesve te kuotave objekt shitblerjeje deklarojne se me deshire te lire dhe te plote i shesin gjithsej 100(njeqind) Pjese te Kapitalit te shoqerise Nishova Energy sh.p.k. (ose perndryshe 100% te Pjeseve te Kapitalit), te zoteruara nga shoqerite "NISHOVA" sh.p.k dhe "ARMANDI" sh.p.k tek bleresit, shoqerite "GEO ENERGY" SRL qe do te zoteroje 50(pesedhjete) pjese dhe "FIDALCO" SPA qe do te zoteroje 50(pesedhjete) pjese.

Bleresit, shoqerite "GEO ENERGY" SRL dhe "FIDALCO" SPA, nepermjet perfaqesuesve te saj z. Isidoro REBATTO dhe z. Gaetano DAL COROBBO, deklarojne se me deshiren e lire dhe te plote blejne gjithsej 100(njeqind) Pjese te Kapitalit (ose 100% te Pjeseve te Kapitalit), te zoteruara nga shoqerite "NISHOVA" sh.p.k dhe "ARMANDI" sh.p.k.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate noteriale, pala shitese humb cdo te drejte pronesie mbi keto Pjese te Kapitalit dhe bleresit behen ortaket e vetem ne shoqeri.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate noteriale dhe rregjistrimin e saj ne QKR, shoqeria "NISHOVA ENERGY" sh.p.k do te zoterohet nga:

1. Ortak: Shoqeria "GEO ENERGY" SRL zoterues ne shoqeri i 50(pesedhjete) Pjeseve te Kapitalit ose ndryshe 50% nga I gjithe kapitali i Shoqerise, me vlere nominale 1000 leke per kuote
2. Ortak: Shoqeria "FIDALCO" SPA zoterues ne shoqeri i 50(pesedhjete) Pjeseve te Kapitalit ose ndryshe 50% nga I gjithe kapitali i Shoqerise, me vlere nominale 1000 leke per kuote

Detyrimet per shoqerite "GEO ENERGY" SRL dhe "FIDALCO" SPA, si ortake ne shoqerine "NISHOVA ENERGY" sh.p.k, fillojne nga data e sotme, qe eshte dhe data e nenshkrimit te kontrates noteriale, dhe nuk ka asnje detyrim financiar apo akte juridik per veprimet e kryera para kesaj date. Per cfare do lloj detyrimi te meparshem nga dita e sotme, I cili nuk rezulton ne bilancin e shoqerise "NISHOVA ENERGY" sh.p.k do te jete ne ngarkim te ortakeve dhe administratorit te meparshem. Ortaket dhe administratori I meparshem i shoqerise "NISHOVA ENERGY" sh.p.k impenjohen per te mbajtur larg te gjitha detyrimeve qe mund te ekzistojne para nenshkrimit te kesaj kontrate shitblerje kuotash per shoqerite Shitese NISHOVA ENERGY shpk; pra, shoqeria "NISHOVA

ARIAN SELFO
Perkthyes
TIRANE

ENERGY" sh.p.k, e perfaqesuar nga shoqerite "NISHOVA" sh.p.k dhe "ARMANDI" sh.p.k. I dorezohet Pales Blerese pa asnje detyrim.

Te gjitha detyrimet dhe taksat ligjore per transferimin e kapitalit te percaktuara ne kete kontrate jane ne ngarkim te pales shitese.

Kontrata perpilohet ne 4(kater) kopje origjinale.ne gjuhen shqipe

Kontrates i bashkangjiten Vendimet e Asamblese se Ortakeve per secilen shoqeri, lejen e METE si dhe dokumentat identifikuese te paleve.

Sa me siper, me kerkese te paleve perpilohet nga une noterja kjo kontrate shitje kuotash e cila iu lexua paleve me ze. Zoterinjve Isidoro REBATTO dhe Gaetano DAL COROBBO, qytetare italiane iu lexua nga perkthyesi, zArjan Selfo perkthyes i gjuhes italiane.

Palet kane deklaruar se sa me siper eshte konform vullnetit te tyre te lire e te plote, e firmosin rregullisht ate, ndersa une e vertetoj ate sipas ligjit.

SHITESIT

"ARMANDI" Sh.P.K

HYSNI BASHA

HYSNI BASHA

"NISHOVA" SH.P.K.

FATMIR KOXHAJ

Fatmir Koxhaj

SH.P.K. Import - Export NISHOVA SKRAPAR - ALBANIA

BLERESIT

GEO ENERGY S.R.L.

"GEO ENERGY" SRL

ISIDORO REBATTO

Isidoro Rebatto

"FIDALCO"SPA

GAETANO DAL COROBBO

Gaetano DAL Corobbo

NOTERE
ANILA GJERMENI

PERKTHYES

ARJAN SELFO

ARJAN SELFO
Perkthyes
TIRANE